

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Statisticient/e i/e ri/e
Departamenti:	i Statistikës
Divizioni:	i Statistikave të Bilancit të Pagesa
Grada:	7
Raporton tek:	Udhëheqësi/e i/e Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Zbaton programin afatshkurtër të Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave në kuadër të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës;
- Mbledh, përpilon dhe validon statistikën e sektorit të jashtëm me qëllim të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes të funksionit statistikor në BQK në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatit statistikën për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave;
- Mban bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët lidhur me çështjet statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës, financës ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Përvoja e punës në statistikë ose disiplina të ngjashme është e dëshirueshme;
- Njohuri e mirë në zbatimin e teknikave moderne statistikore;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Gjuha angleze e preferuar;
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike.
- Aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë të paplanifikuara.
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **8 qershor 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**